

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit të përqendrimit të parashtruar nga **LEO II-VV11 GmbH** me seli në Ottostrasse 1, 80333 Munihi, Gjermani, nëpërmjet Shoqatës së Avokatëve Polenak nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 15.11.2022, solli

### AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi me të cilin LEO II-VV11 GmbH me seli në Ottostrasse 1, 80333 Munihi, Gjermani, synon të fitoj në mënyrë indirekte kontrollin mbi Vitesco Technologies Emitec GmbH, me seli në Hauptstrasse 128, 53797 Lochmar, Gjermani, shoqëritë e varura të sapokrijuara të Vitesco Technologies Emitec GmbH në Japoni, SHBA, Kore, Indi dhe Kinë, duke përfshirë bizneset e shkëputura në vend të Vitesco Technologies GmbH, me seli në Siemensstrasse 12, 93055 Regensburg, Gjermani, pasuri të paluajtshme në Lochmar dhe Eisenach, Gjermani, dhe punonjës të caktuar dhe të drejta të pronësisë intelektuale në lidhje me atë që u tha më lartë, nëpërmjet të blerjes së pjesëve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative ( Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 10000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbarrimin e aktvendimit.

### Arsyetim

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës më 25.10.2022, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Komisioni) është dorëzuar njoftimi i përqendrimit nga LEO II-VV11 GmbH me seli në Ottostrasse 1, 80333 Munihi, Gjermani, ku LEO II-VV11 GmbH synon të fitoj në mënyrë indirekte kontrollin mbi Vitesco Technologies Emitec GmbH, me seli në Hauptstrasse 128, 53797 Lochmar, Gjermani, shoqëritë e varura të sapokrijuara të Vitesco Technologies Emitec GmbH në Japoni, SHBA, Kore, Indi dhe Kinë, duke përfshirë bizneset e shkëputura në vend të Vitesco Technologies GmbH, me seli në Siemensstrasse 12, 93055 Regensburg, Gjermani, pasuri të

paluajtshme në Lochmar dhe Eisenach, Gjermani, dhe punonjës të caktuar dhe të drejta të pronësisë intelektuale në lidhje me atë që u tha më lartë, nëpërmjet të blerjes së pjesëve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

#### **Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:**

**LEO II-VV11 GmbH** është një shoqëri për qëllime të veçanta që operon si një shoqëri holding. LEO II-VV11 është një shoqëri e varur indirekte që është 70% në pronësi të Lenbah Ekviti Opportunities II. GmbH & Co. KG (Lenbach Equity Opportunities II. GmbH & Co. KG), një fond kapitali privat i këshilluar nga DUBAG. Grupi DUBAG është një ekip i specializuar këshillues për investime me qendër në Munihi, i cili menaxhon fondet e kapitalit privat, qëllimi i të cilit është blerja dhe zhvillimi aktiv i shoqërive në situata të veçanta.

LEO II nuk ka shoqëri të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Kompania e vetme e portofolit nga grupi **LEO II** që tregtoi produkte/shërbime në Maqedoninë e Veriut në vitin 2021 ishte KATENSIS.

**Emitek Biznisot** me seli në Gjermani, siguron baza katalizatorësh të cilat përdoren në zgjidhjet e pajisjeve për reduktimin e emetimeve në industrinë e automobilave, duke përfshirë makinat e pasagjerëve, automjetet e lehta dhe të rënda tregtare, pajisjet industriale dhe makinat me dy rrota. Është aktive në zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve për të reduktuar emetimet e ndotësve, siç janë bartësit të katalizatorëve metalikë, katalizatorët me ngrohje elektrike dhe filtrat për motorët me djegie të brendshme.

VT Emitek nuk ka shoqëri të regjistruara në Republikën e Maqedonisë së Veriut. VT Emitek u shet prodhuesve globalë të automobilave (OEM). Asnjë nga këto OEM nuk është me seli në Republikën e Maqedonisë së Veriut. OEM më pas përcaktojnë zinxhirët e furnizimit dhe udhëzojnë VT Emitek që të dorëzojë produktet tek furnizuesit që ata zgjedhin.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

### **Udhëzim për mjetin juridik**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

**KRYETAR**  
**I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**  
**Prof. Dr. Владимир Наумовски**